



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 219/1 prot.

Memaliaj më 05.01.2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në sallën e Këshillit Bashkiak.

Ora e fillimit të mbledhjes 11:00.

Këshilltarë pjesëmarrës 13 këshilltarë në momentin e fillimit të mbledhjes.

Kryesuesi i mbledhjes Z.Erjon Sinanaj/ Kryetar këshilli.

Mbledhja deklarohet e hapur nga kryetari i këshillit.

Njihen këshilltarët me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.12.2025.
3. Informacion mbi vendimet e datës 24.12.2025 dhe 29.12.2025.
4. **Projekt vendim:** “Për miratimin e kriterëve ,procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok – ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor”.
5. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin dhjetor 2025”.
6. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin janar 2026”.
7. **Projekt vendim:** “Për miratimin e marrjes me qera të një ambienti për shërbime në funksion të të moshuarve” .
8. **Projekt vendim:** “Për miratimin e listës emërore për vlerën maksimale të subvecionit të qerasë në tregun elirë 2026”.
9. **Projekt vendim:** “Për miratimin e një ndryshimi në nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera për vitin 2026”.
10. **Projekt vendim:** “Kufinj të financimit dhe miratimin e listës së familjeve për projektin e strehimit në vitin 2026 (Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese)për komunitete të varfëradhe të pafavorizuara nga Bashkia Memaliaj ”.
11. **Projekt vendim:** “Për miratimin e kalimit të grantit në kuadër të GBP ”.

1128 **12. Projekt vendim:** “Për miratimin e planit social të Bashkisë Memaliaj për periudhën 2026-2029”.

13. Projekt vendim: “Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore të Bashkisë Memaliaj për periudhën 2026 -2029”.

14. Projekt vendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për disa qytetarë”.

15. Projekt vendim: “Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavanëve përfundimtare të PBA 2026-2029”.

Esmerald Xhemali: Propozoj që pika 7 e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës e kaluam dhe propozuam në komision të përcaktohet shuma në projekt vendim dhe të sillet informacion nëse ka një VKB për të përcaktuar vendin që ka qenë përcaktuar për pensionistët. Pasi të sqarohen këto të vij për miratim pasi të kemi informacionin e plotë.

Erjon Sinanaj: Mos ka një vendim për këtë dhe po marrim një vendim tjetër.

Xhevit Kacorri: Mos nuk kemi përplasje se bashkia mund të marri 2-3 ambiente me qera.

Hidhet në votim propozimi i Esmeraldit.

Vota Pro 9 vota.

Vota Kundër 4 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

F. Mushamati: Shoqata Tafil Buzi ka bërë një kërkesë për një ambient për muze, materiali ka ardhur dhe , unë propozoj ta fusim në rend dite.

Hidhet në votim propozimi i Flamur Mushamatit.

Vota Pro 7 vota.

Vota Kundër 2 vota.

Vota Abstenim 4 vota.

Pika 1.Miratohet rendi i ditës me ndryshime.

Të kalohet te pika 7 në vend të pikës që hoqëm.

Hidhet në votim.

Vota Pro 5 vota.

Vota Kundër 3 vota.

Vota Abstenim 5 vota. Nuk miratohet.

Kryetari: Propozimi i Flamurit kalon në fund të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.12.2025.
3. Informacion mbi vendimet e datës 24.12.2025 dhe 29.12.2025.
4. **Projekt vendim:** “Për miratimin e kritereve ,procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok – ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor”.
5. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin dhjetor 2025”.
6. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin janar 2026”.
7. **Projekt vendim:** “Për miratimin e listës emërore për vlerën maksimale të subvecionit të qerasë në tregun e lirë 2026”.

8. **Projekt vendim:** "Për miratimin e një ndryshimi në nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera për vitin 2026".
9. **Projekt vendim:** "Kufinjtë e financimit dhe miratimin e listës së familjeve për projektin e strehimit në vitin 2026 (Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese)për komunitete të varfëradhe të pafavorizuara nga Bashkia Memaliaj ".
10. **Projekt vendim:** "Për miratimin e kalimit të grantit në kuadër të GBP".
11. **Projekt vendim:** "Për miratimin e planit social të Bashkisë Memaliaj për periudhën 2026-2029".
12. **Projekt vendim:** "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore të Bashkisë Memaliaj për periudhën 2026 -2029".
13. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për disa qytetarë".
14. **Projekt vendim:** "Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavaneve përfundimtare të PBA 2026-2029".
15. **Projekt vendim:** "Për miratimin e ndryshimit të funksionit të një objekti ekzistues me nr pasurie 469-n1,zk 1335 e ashtuquajtur ish ppt, në muze kushtuar heroit Tafil Buzi "Nderi i Kombit"

Pika 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.12.2025 .

Hidhet në votim.

Vota Pro 13 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 3. Informacion mbi vendimet e mbledhjes së datës 29.12.2025 .

Pika 4. " **Projekt vendim:** "Për miratimin e kriterëve ,procedurave , dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok – ndihmës ekonomike deri 6% ose me fondet e buxhetit vendor".

Arsola Muzha: Ne e kaluam në këshill janë sipas ligjit ashtu siç kanë kaluar edhe vitin e kaluar dhe ju ftoj ta kalojmë pa diskutim.

Hidhet në votim.

Vota Pro 13 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 5.**Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin dhjetor 2025".

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 13 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 6. " **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin janar 2026".

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 13 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 7. Projekt vendim: “Për miratimin e listës emërore për vlerën maksimale të subvecionit të qerasë në tregun e lirë 2026”.

Esmerald Xhemali: Ne si komision u mbledhëm dhe i kemi kërkuar specialistit të sjellë dosjet për secilin aplikant për bonusin e qirasë dhe përmirësimin e banesave.

Relaton Z. Mikel Salia sipas relacionit bashkangjitur.

Flamur Mushamati: Unë propozoj të kalojmë në pikën tjetër sa të vinë dosjet.

Arsola Muzha: O.Tafili a ka urdhër mbrojtjeje se këtu është shënuar me dhunë në familje.

Asqeri Muçoima: Nuk pranoj të thuhet po s'kaloi digjet. Është e disajta herë që vini këtu pa materiale.

Jeni administratë e pa aftë.

Afize Sula: Qeveria ka nxjerrë sisteme , për të mbrojtur larg informacioneve. Fakti që ju aplikoni për ta kërkon ta indimidoni qytetarit.

Erjon Sinanaj:Fakti që vini pa materiale jeni ju me vonesë.

Esmerald Xhemali: Vetëm aplikanti sjellë vërtetim papunësie.

Mikel Salia: Aq kërkon sistemi ,vetëm aplikanti.

Erjon Sinanaj: Kur bëni dokumentacionin bëhuni të përgjegjshëm, silleni tamam.

Bujar Mamaj: Unë këtu bëj me faj bashkinë. Qytetari ta bëj vetë aplikimin në sistem e bëjmë kot me faj Mikelin. Unë propozoj ta kalojmë.

Hidhet në votim.

Vota Pro 9 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 4 vota. Miratohet. A.H; A.M; A.MUZHA; E.XH.

Pika 8. Projekt vendim: “Për miratimin e një ndryshimi në nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera për vitin 2026”.

E. Xhemali: Ne si komision u mbledhëm dhe propozuam ndryshime me sa pashë janë pranuar nga administrata.

1. Të hiqej nëndrejtori te drejtoria e shërbimeve.

2. Të barazojë pagën e kamionistve me të manovratorëve.

Si rrallë herë propozimet e komisionit pranohen nga administrata, unë ju ftoj ta votoni.

Relaton Znj. Xhuvana Kuçi sipas relacionit bashkangjitur.

Asqeri Muçoima: Juristja tha nga 253 shkon në 270 numri i strukturës . Unë di që bashkia ka pasur 259 punonjës në vitin 2025 jo 253 ,korrigjojini këto.

Afize Sula: Pse është e nevojshme të shtyhen 11 punonjës .

Xhuvana Kuçi: Duke pasur parasysh fluksin e qytetarëve kemi menduar të shtojmë një punonjës te

One - Stop shop.

Afize Sula: Kemi rritje të popullsisë që është shtuar fluksi? Kemi gjë dadabazë?

Xhuvana Kuçi: Jo nuk kemi një statistikë.

Anest Halili: Ne kemi kaluar buxhetin me 266 punonjës , sot vini me 270 . Ku do të gjenden lekët për pagat?

Besnik Caushi: Në buxhet i kemi parashikuar 6 punonjës të MZSH-ja po 3 do të punësojmë se s'kemi lekë. Ne kemi bërë kërkesë për shtesë. Ne me 3 punonjës e përballojmë 3 do të lëmë pa punësuar.
Xhevit Kacorri: Në këndvështrimin tim është gjë e mirë që hapen vende pune ju ftoj ta votojmë.
Flamur Mushamati: Unë ju ftoj ta votojmë sepse vet kemi ngritur shqetësimin për pastrimin e zonave rurale.

Hidhet në votim.

Vota Pro 11 vota

Vota Kundër 2 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 9 . Projekt vendim: “Kufinjtë e financimit dhe miratimin e listës së familjeve për projektin e strehimit në vitin 2026 (Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese)për komunitete të varfëradhe të pafavorizuara nga Bashkia Memaliaj”.

Esmerald Xhemali: Ne si komision u mbledhëm, dosjet mungonin, propozoj të kalojmë në një mbledhje të veçantë nëse kërkon ta kalojmë po pa debat hajde ta kalojmë. Tjetër kemi kërkuar listën e përfituesve për 3 vite nga zyra e urbanistikës dhe nuk na është vënë në dispozicion.

Irena Jaupi: Është një dosje që nuk është futur në projekt vendim, propozoj të shtohet Alem Jaupi.

Mikel Salia: Është harruar sepse ka ardhur pak me vonesë. Nëse ju e votoni e shtojmë emrin në listë.

Taulant Rama: Pse nuk na e sillni grupin e punës që ka administruar këto kërkesa? Ka nga ata që janë skualifikuar nga ana juaj?

Mikel Salia: Po disa janë filtruar nga ana jonë sepse nuk kanë pasur dokumentat e sakta.

Arsola Muzha: Pse më sjellë mua të gjithë listën kur nuk kanë aplikuar në sistem?

Taulant Rama: Kjo ka kosto Pse nuk vinë këtu vetëm ata që kanë aplikuar në sistem?

Afize Sula: Kam disa pyetje që më lindin natyrshëm për shkak të debatit. Juve ju ka ardhur njoftimi për mbledhje komisioni, pse nuk përgatiteni me materialet përkatëse që na çojnë në debat dhe na vendosin ne me shpatulla për muri, për ta kaluar pa qenë të qartë. Nuk është e drejtë të rrinë banorët jashtë se neve na kanë votuar për t'u shërbyer.

Asqeri Muçoima: Kjo listë që pashë, shoh që ka persona me biznese të mëdha. Ai komisioni e ka vërtetuar listën në terren? Unë nuk di se çfarë marrëveshje ka bërë bashkia Memaliaj që të hallehinjtë jashtë dhe fut këtu ata që kanë mundësi të restaurojnë banesat. Fatmira Rama pse nuk është te kjo listë kur e ka sjellë dosjen?

Mikel Salia: E shtojmë.

Xhevit Kacorri: Unë do të përforcoja fjalën e profesor Asqerit, ka biznesmenë te kjo listë. Ndihej i shqetësuar për një hallexhi si Edmond Nano që nuk është futur këtu. Në disa lista janë të afërm, familjarë të punonjësve të bashkisë, jemi futur në një rreth vicioz. Unë propozoj ta kalojmë një për një.

Arsola Muzha: Te lista e parë kishe burrin e financieres së bashkisë pse nuk e kalove një për një?

Anest Halili: Pse nuk e kalove listën një për një?

Mikel Salia: Për Edmond Nanon nuk e plotëson kushtin që ka pronë dhe kjo e bën të pamundur aplikimin.

Anest Halili: Pse nuk e keni futur te bonusi i qirasë?

Mikel Salia: Nuk ka bërë kërkesë.

Largohet nga mbledhja Irena Jaupi.

Esmerald Xhemali: Unë nuk pranoj kompromisë jam me Xhevitin, të kalojmë një për një. Atyre hallexhinjve ua përmende emrin, po atyre abuzuesve.

Vasil Nasi / pensionist, përfaqësues i shoqatës së invalidëve.

Unë jam këtu si qytetar dhe u ndjeva mirë për këtë mbledhje në mënyrën se si po zhvillohet. Ju falënderoj që mbronin të drejtat e qytetarëve duke kaluar në filtra dhe i kërkoni llogari administratës.

Taulant Rama: Ne i japim ok pasi kanë kaluar në komisione se këtu nuk na del koha ,prandaj janë komisionet.

Flamur Mushamati: E falënderoj zotërinë! Përsa i përket njësisë time i kam verifikuar dhe janë të gjitha familje në nevojë.

Xhevit Kacorri: Unë do të doja që kjo tabelë të ndahej sipas njësive.

Bujar Mamaj: Para 2 vitesh kryetari i bashkisë na dha fjalën se do ta rregullonte ai banesën e Edmond Nanos.

Esmerald Xhemali: Unë kam dijeni që bashkia ka bërë përpjekje por personi në fjalë është pak i vështirë dhe sopranon të dal nga shtëpia që bashkia të ndërhyjë.

Afize Sula: Sa kohë ke me këto dosje?

Mikel Salia: Thirrja është hapur në nëntor dhe aplikimet bëhen në janar.

Erjon Sinanaj: Hidhet në votim duke shtuar 2 emrat e propozuar nga këshilltarët.

Vota Pro 9 vota.

Vota Kundër 2 vota. A.Sula; E. Xhemali.

Vota Abstenim 1 votë. A.Muzha Miratohet.

Pika 10. **Projekt vendim:** “Për miratimin e kalimit të grantit në kuadër të GBP”.

Vjen në mbledhje Irena Jaupi.

Relaton Z. Besnik Caushi sipas relacionit bashkangjitur.

Erjon Sinanaj: Për çfarë do të kalojë konkretisht ky grand?

Besnik Caushi: Për firmën e pastrimit 6 mil lekë dhe disa shtëpiza që janë bërë dhe nuk janë shlyer në shumën 9 mil lekë për vitin 2025.

Hidhet në votim.

Vota Pro 12 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 11. **Projekt vendim:** “Për miratimin e planit social të Bashkisë Memaliaj për periudhën 2026-2029”.

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 12 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Afize Sula nuk mori pjesë në votim.

Pika 12. **Projekt vendim:** “Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore të Bashkisë Memaliaj për periudhën 2026 -2029”.

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur

Hidhet në votim .

Vota Pro 12 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Afize Sula nuk mori pjesë në votim.

Pika 13. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për disa qytetarë”.

Relaton Z. Besnik Caushi sipas relacionit bashkangjitur.

Erjon Sinanaj: Doja të dija të dija mbi mënyrën e përzgjedhjes pasi është bërë një kërkesë nga një banor i fshati Memaliaj për dy banorë të fshatit që ishin çift i moshuar pa fëmijë dhe ata kanë një muaj që ndërruam jetë. Pse nuk është marrë parasysh?

Besnik Caushi: Ju e dini që kur është bërë kërkesa ne nuk funksiononim.

Esmerald Xhemali: Janë pranuar nga ne këto ndihma si komision dhe kemi propozuar të ndahen dhe është pranuar nga financa . Do të propozoja një fond të veçantë që të kishte titullarit mundësi të kalonte në raste emergjente sepse satën vij këtu në këshilli në rastin më të mirë kalon 1 muaj.

Besnik Caushi: Titullari nuk mund t'i kaloj nga një zë në tjetrin pa një VKB.

Asqeri Muçoima: 1. Një kërkesë e bërë nga familja Nana ka ardhur sepse janë familje vërtetë në nevojë.

2. Për pagat e sportit, pse nuk kanë kaluar?

Besnik Caushi: Ne si bashki ua kemi kaluar po ata janë OJF ne nuk i kontrollojmë dot.

Erjon Sinanaj: Hidhen në votim në bllok 6 vendimet për dhënie ndihmë financiare.

Vota Pro 13 Vota.

Vota Kundër 0 Vota.

Vota Abstenim 0 Vota. Miratohet .

Xhevit Kacorri: Kam një kërkesë, sa është dëmi në bashkinë tonë gjatë përgatitjeve të ndodhura gjatë ditëve të para të janarit?

Pika 14. **Projekt vendim:** “Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavanëve përfundimtare të PBA 2026-2029”.

Relaton Z. Besnik Caushi sipas relacionit bashkangjitur.

Esmerald Xhemali: Ne e diskutuam në komision duke qenë se PBA kalon para ose bashkë me buxhetin. Se këto i kalojnë pa neve, se ne kaluam buxhetin pa debat.

Erjon Sinanaj: Hidhet në votim PBA

Vota Pro 13 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Pika 15. **Projekt vendim:** “Për miratimin e ndryshimit të funksionit të një objekti ekzistues me nr. pasurie 469-n1,zk 1335 e ashtuquajtur ish ppt, në muze kushtuar heroit Tafil Buzi “Nderi i Kombit”

Esmerald Xhemali: Dua t'ju njoh me një informacion për figurën e Tafil Buzit. Unë ju bëj thirrje të mos e votojmë këtë vendim. (Informacioni bashkangjitur.)

Largohet Irena Jaupi nga mbledhja.

Asqeri Muçoima: Nuk kemi të drejtë të paragjykojmë shoqata, nisur nga ajo që dëgjova. Një profesor i huaj ka thënë ne atje ku s'kemi heronj i shpikim , ju shqiptarët i përçmoni.

Taulant Rama: Meqënëse jam në komisionin e kulturës dhe materiali na erdhi sot dhe ne e futëm në rend dite . Nuk jemi këtu për të vlerësuar figurën historike , por unë mbështes iniciativën e shoqatës . Unë jam i ndjeshëm për këto figura nisur edhe për shkak të profesionit. Para vitit 1992 kishte muze në çdo fshat dhe u shkatërruan dhe më vjen mirë që muzetë po kthehen . Muzeu etnografik nuk është futur në trashenë e ligjit të muzeve. Jam dakord për miratimin.

Xhevit Kacorri: Dua të di do marrim 2 vendime?

Leonora Mici relaton sipas relacionit bashkangjitur.

Esmerald Xhemali: Si do të jepet, me qera apo në përdorim? Ky inventar është bërë që nga koha e komunave dhe ti nuk ke certifikatë. Apliko për certifikatë dhe eja këtu për miratim. Me shumë mundësi kjo pronë mund të jetë pronë e Postës Shqiptare dhe ti nuk mund ta japësh.

Ligji thotë kur jep me qera, në përdorim apo shet duhet certifikatë pronësie. Nuk futesh dot në marrëdhënie juridike pa dokument pronësie.

Xhevit Kacorri: Në këndvështrimin tim përderisa është pronë e shtetit, ta japim.

Arsola Muzha: Ajo që është e postës është e postës sepse kryetari i bashkisë u ankua për pagesat e postës në një nga mbledhjet e Këshillit.

Leonora Mici: Ne nuk po e shesim po e japim në përdorim.

Esmerald Xhemali: Dokumentat nuk janë origjinale dhe unë propozoj që prefektura ta shoh me prioritet sepse unë do ta çoj në gjykatë administrative dhe më lartë nëse konfirmohet nga prefektura.

Taulant Rama: Ajo që unë mendoj meqë ka debat për certifikatën të kaloj në parim dhe të pajiset me dokumentacion para se të lidhet kontrata.

Hidhet në votim.

Vota Pro 9 vota.

Vota Kundër 3 vota. A. Sula; A. Muzha; E. Xhemali. Miratohet.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Këshilltarët të pranishëm në mbledhje.

1. Flamur Mushamati
2. Taulant Rama
3. Anest Halili
4. Asqeri Muçoima
5. Arsola Muzha
6. Afize Sula
7. Lauresha Lila
8. Xhevit Kacorri
9. Esmerald Xhemali
10. Bujar Mamaj
11. Irena Jaupi
12. Maltona Bërxi
13. Erjon Sinanaj

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka

